




Dhuna në familje dhe (mos)besueshmëria në Policinë e Kosovës

Shoqëria kosovare gjendet në mes të 'vakumit të besimit' dhe vitet e fundit në veçanti e kanë reflektuar këtë degradim të besimit që ka arritur pikën më të lartë. Këtë më së miri e ilustron rënia e besueshmërisë ndaj qeverisë dhe institucioneve në përgjithësi. Nivel të ulët të besimit të qytetarëve ka edhe ndaj Prokurorisë së Kosovës (29%) dhe Gjykatave të Kosovës (25%).

Mirëpo, ky mosbesim kolektiv duket se i ka prekur më pak institucionet e sigurisë në Kosovë. Shtatë edicionet e Barometrit Kosovar të Sigurisë (2011 - 2017) kanë rreshtuar Policinë e Kosovës krahas institucioneve më të besueshme të sigurisë dhe drejtësisë në Kosovë. Perceptimi i qytetarëve të Kosovës ndaj Policisë së Kosovës (PK) ka shënuar lëvizje në drejtim pozitiv gjatë vitit 2017, ku nga 56% në 2016 përqindja e respondentëve që i kanë besuar KP-së është rritur në 62%.

Për më tepër, PK shihet si instanca e parë për raportim të problemeve që hasen në përditshmëri nga qytetarët e Kosovës, ani pse kontakt të drejtpërdrejtë me policinë kanë deklaruar së kanë pasur vetëm 5% e respondentëve.


Rasti i vrasjes së Valbona Ndrecaj në Gjakovë ka hapur debat në opinionin publik për përgjegjshmërinë e Policisë së Kosovës si instancë e parë e raportimit të problemeve në familje. Kjo ka vënë në diskutim integritetin dhe përgjegjshmërinë e anëtarëve të PK për të adresuar raste të tilla.



Besimi bazuar në gjini

Rreth 2 në 3 (64%) të anketuarë (femra) i besonin PK-së krahasuar me 3 në 5 (59%) të anketuar meshkuj;

Përafërsisht 1 në 7 (15%) të anketuarë (femra) i besonin PK-së krahasuar me 1 në 6 (17%) të anketuar meshkuj.



Një vështrim më i detajuar i rezultateve të BKS 2017 në bazë të gjinisë tregon se gratë i besojnë PK-së më shumë se burrat. Rreth 64% të grave kanë pohuar se i besojnë plotësisht PK-së në krahasim me 59% e të anketuarve burra.

Njëra ndër arsyet se pse gratë i besojnë këtij institucioni mund të jetë i ndërlidhur me faktin se gratë janë më tepër të predispozuar të mendojnë se mund të jenë viktime të krimit dhe shohin mbështetjen në PK.

Megjithatë, ky nivel i besimit ndaj PK-së mund të sfidohet nga ngjarja e fundit, vrasja e Valbona Ndrecaj në Gjakovë, rast i dhunës në familje për të cilin viktimja kishte raportuar vazhdimisht, mirëpo Policia dështoi që t'i ofroj mbrojtje.

Rasti i Valbona Ndrecaj reflekton në faktin që rastet e dhunës në familje nuk prioritizohen nga Policia e Kosovës dhe për më tepër këto raste nuk pasohen në hetuesi në bazë të nivelit të rrezikut.

Për më tepër, ky rast tregon se dështimi për të analizuar nivelin e rrezikut dhe për të ofruar mbrojtje apo mbështetje duke i dhënë çasje të hershme viktimës në shërbime të specializuara apo duke i dhënë mbështetje, ka përfunduar në tragjedi. Stafi dhe zyrtarët e Policisë së Kosovës kanë dështuar të kuptojnë dinamikën e abuzimit në familje, si dhe qëndrimet dhe sjelljet e autorit të krimit, precedentit penal dhe sjelljet e përgjithshme të tyre në shoqëri. Për më tepër, Policia e Kosovës duhet të sigurojë se zyrtarët dhe stafi demonstronjë mirëkuptim, qëndrim dhe sjellje mbështetëse ndaj viktimave.

Neglizhenca e Policisë së Kosovës dhe arsyetimi i mangët në konferencën për media ka ngjallur reagime të ashpra në lidhje me efikasitetin dhe përgjegjshmërinë e Policisë së Kosovës.

Inspektorati Policor i Kosovës ka marrë iniciativë për të hetuar disa zyrtarë të policisë në Gjakovë për neglizhencë dhe moskryerje të detyrave. Hetimi i pasuar nga IPK rezultoi në deklaratë të ngjashme me atë të Policisë së Kosovës. Po e njëjta deklaratë e lëshuar nga Inspektorati Policor i Kosovës - pas një periudhe tejet të shkurtë kohore të hetimeve, edhe më tej reflekton mungesën e kapaciteteve profesionale si dhe vullnetin për të prioritizuar rastet e dhunës në familje, sidomos dhunës ndaj grave.

Raste të tilla të neglizhencës së institucioneve të rendit për të zgjidhur rastet e dhunës në familje dhe mungesa e kapaciteteve për të proceduar me raste të tilla përveç që stimulon sjellje të ngjashme si pasojë e mosndëshkueshmërisë, ndikojnë drejtëpërdrejtë në numrin e rasteve të dhunës në familje të paraqitura në Polici të Kosovës. Këtë më së miri e ilustron grafiku i mëposhtëm ku gjatë vitit 2017 janë shënuar vetëm 1125 raste të dhunës në familje në Polici. Për më tepër, ky numër mund të jetë edhe më i madh nëse numrohen rastet ku Policia e Kosovës e ndërmjetëson një konflikt brenda familjes pa e proceduar rastin formalisht.



Numri i Rasteve të Raportuara të Dhunës në Familje sipas vitit

Burimi: Kosovo's Women's Network (2017) From Words to Action?: Monitoring the Institutional Response to Gender-Based Violence in Kosovo, Gjindet në: <http://www.womens-network.org/documents/20180312142859762.pdf>


Si përceptohet dhuna në familje në Kosovë?

Neglizhenca e Policisë së Kosovës dhe e shoqërisë për t'u përgjigjur me sukses thirrjeve për ndihmë në raste të dhunës në familje mund të jetë edhe si rezultat i normalizimit të dhunës në familje brenda shoqërisë. Në kuadër të Barometrit Kosovar të Sigurisë, QKSS ka matur edhe perceptimet e qytetarëve për dhunën në familje.

Vetëm 19,85% e respondentëve kanë deklaruar se dhuna në familje paraqet rrezik në Kosovë, përcjellur nga 10,88% që kanë pohuar se është rrezik deri diku, duke arsyetuar se është problem i përgjithshëm që ekziston në shoqëri mirëpo ata personalisht nuk kanë qenë asnjëherë viktimë e dhunës në familje. Këto raste vazhdimisht u janë referuar rrethit (fshat ose qytet) ku kanë ndodhur raste të vrasjeve ose dhunës së raportuar në polici.

Ndërkaq, 69,27% kanë deklaruar se dhuna në familje nuk është aspak rrezik në Kosovë. Duhet pasur parasysh përqindja e ulët e të anketuarve që nuk e shohin dhunën në familje si rrezik vjen si rrjedhojë e nivelizimit të dhunës, ku në të shumtën e rasteve dhunë është konsideruar vetëm vrasja ose tragjedi të ngjashme, apo në raste të tjera ku ka pasur hezitim për të dhënë përgjigje.

Përceptimet e Qytetarëve mbi Rrezikshmërinë e Dhunës në Familje



Një vështrim më i detajuar i rezultateve në bazë të rajonit tregon se në rajonet e Mitrovicës, Pejës, Prizrenit, Gjakovës dhe Mitrovicës së Veriut 20%-30% e respondentëve e konsiderojnë dhunën në familje si rrezik, kurse në rajonin e Prishtinës, Gjilanit dhe Ferizajit kjo përqindje ka variuar nga 10%-20%.

Përceptimet e Qytetarëve mbi Rrezikshmërinë e Dhunës në Familje

